



Memorandum i Mirëkuptimit

Në mes të

Odës së Avokatëve të Kosovës

Dhe

Fakultetit Juridik të Kolegjit ILIRIA

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MiM) është themelimi i bashkëpunimit në mes të Fakultetit Juridik të Kolegjit ILIRIA (Fakultetit Juridik) dhe Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK) për mundësimin e mbajtjes së praktikës së studentëve të Fakultetit Juridik të Kolegjit ILIRIA në Odën e Avokatëve të Kosovës.

Neni 2 Obligimet e Fakultetit Juridik

- 2.1** Fakulteti Juridik obligohet të koordinojë praktikën e studentëve me personat përgjegjës në Odën e Avokatëve të Kosovës, në mënyrë që të sigurohet se puna praktike e studentëve në Odën e Avokatëve të Kosovës vlerësohet dhe konsiderohet si pjesë shtesë e mësimit teorik të studentëve.
- 2.2** Fakulteti Juridik obligohet që ta njoftojë më kohë Odën e Avokatëve të Kosovës se kur mund të shpallen konkurset për praktikë dhe sipas nevojave të Odës së Avokatëve të Kosovës të siguroj numrin e studentëve për praktikë.
- 2.3** Fakulteti Juridik obligohet të përgatis dhe të mirëmbajë regjistrin me emrat e studentëve dhe kohën në të cilën studentët do ta kryejnë praktikën në Odën e Avokatëve të Kosovës dhe të ia dërgojë Odës së Avokatëve të Kosovës listën e praktikantëve një javë para fillimit të mbajtjes së praktikës.
- 2.4** Përzgjedhja e CV-ve të studenteve dhe përzgjedhja finale e studentëve do të bëhet nga Oda e Avokatëve të Kosovës.

- 2.5. Fakulteti Juridik do të bashkëpunojë me Odën e Avokatëve të Kosovës në aplikimin për dhe realizimin e projekteve të përbashkëta profesionale dhe shkencore.
- 2.6 Fakulteti Juridik do të angazhojë avokatët ekspertë nga Oda e Avokatëve të Kosovës në programet e praktikës juridike brenda programeve akademike të Kolegjit ILIRIA, në veçanti në mësimin klinik.
- 2.7 Fakulteti Juridik dhe Oda e Avokatëve të Kosovës do të bashkëpunojnë në përgatitjen dhe shkëmbimin e punimeve profesionale dhe shkencore për publikimet e ndërsjella.

Neni 3

Obligimet e Odës së Avokatëve të Kosovës

- 3.1 Oda e Avokatëve të Kosovës obligohet që ta koordinoj punën e praktikës së studentëve me Fakultetin Juridik në mënyrë që t'i mundësohet studentëve të Fakultetit Juridik mbajtjen e praktikës tre mujore në Odën e Avokatëve të Kosovës.
- 3.2 Oda e Avokatëve të Kosovës obligohet që ta njoftoj Fakultetin Juridik me kohë për numrin e studentëve që mund ti marrin për praktikë dhe po ashtu ti caktojë kriteret/kualifikimet për studentët.
- 3.3 Oda e Avokatëve të Kosovës obligohet të njoftojë Fakultetin Juridik që studentët do ta mbajnë praktikën në kohën dhe vendin e caktuar dhe në fund të praktikës ti pajisë studentët me një certifikatë si dëshmi që praktika është mbajtur.
- 3.4 Oda e Avokatëve të Kosovës do të bashkëpunojë me Fakultetin Juridik në aplikimin për dhe realizimin e projekteve të përbashkëta profesionale dhe shkencore.
- 3.5 Sipas kërkesës së Fakultetit Juridik, Oda e Avokatëve të Kosovës do të vejë në dispozicion avokatët ekspertë për ligjërime në programet e praktikës juridike brenda programeve akademike të Kolegjit ILIRIA, në veçanti në mësimin klinik.
- 3.7 Oda e Avokatëve të Kosovës do të bashkëpunojë me Fakultetin Juridik në përgatitjen dhe shkëmbimin e punimeve profesionale dhe shkencore për publikimet e ndërsjella.


Neni 4
Kohëzgjatja e Memorandumit

- 4.1 Ky MiM nënshkruhet për periudhën 1 (një) vjeçare, me mundësi vazhdimi.
- 4.2 Në rast se asnjëra nga palët nënshkruese nuk e paralajmëron shkëputjen e këtij MiM një muaj para përfundimit të tij, MiM konsiderohet të jetë vazhduar me automatizëm.


Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga palët.

Në pajtim të plotë, palët e nënshkruajnë këtë Memorandum të Mirëkuptimit më datë 29 Korrik 2013.


Oda e Avokatëve të Kosovës
Ibrahim Dobruna
Kryetar




Fakulteti Juridik Kolegji ILIRIA
Mixhait Reçi
President i Kolegjit ILIRIA